

---

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2002/8**

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2002/3 MBI TATIMIN NË  
TË ARDHURAT PERSONALE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/4 të datës 20 shkurt 2002 për Tatimin në të ardhurat personale në Kosovë,

Duke marrë parasysh se për periudhën tatimore 2002 tatimi në të ardhurat personale u ngarkohet të ardhurave të tatueshme të tatimpaguesve prej datës 1 prill 2002,

Me anë të kësaj shpall këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1

Përlllogaritja e tatimit në fitim për periudhën tatimore 2002

1.1 Për periudhën tatimore 2002, tatimi në të ardhurat personale u ngarkohet të ardhurave të fituara ndërmjet datës 1 prill 2002 dhe 31 dhjetor 2002.

1.2. Nivelet e tatimit në të ardhura për vitin 2002 të përshkruara në nenin 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/4 duhet të ndryshohen proporcionalisht (nëntë të dymbëdhjetat) për periudhën nëntëmujore të përcaktuar në nenin 1.1. Këto ndryshime duhet të pasqyrohen në tabelat e ndalesave të cilat do të shpallen nga Autoriteti Qendror Fiskal në përputhje me nenin 7.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/4.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 29 mars të vitit 2002.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm